



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilmen/Prodato Received/Delivery	09.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMSHUK	4659/2023		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.772/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.772/2023 të datës 24.05.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 09.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.772/2023 e datës 24.05.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi 14-101/03-62754/23 i datës 23.03.2023, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Arsyetim

Nëpunësja civile e punësuar në Komunën e Prishtinës në Drejtorin e Financave me pozitën e punës "Asistente Administrative 3", me datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit 14-101/03-62754/23 i datës 23.03.2023, të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me pretendimin që vendimi i kundërshtuar nuk është i drejtë përkatësisht ka shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë

25.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës. Ndërsa, Këshilli me datë 01.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4397/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-118/02-42503/23 të datës 27.02.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimi 14-101/03-62754/23 i datës 23.03.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Autorizimi i ankuesit për Avokatin i datës 19.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 01.06.2023; Akt emërimit me numër 112-332 të datës 01.02.2017; Përshkrimin e detyrave të punës; Listën e pagave për muajin mars dhe shkurt 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të shkresave të lëndës, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *Sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit/Komuna e Prishtinës, më datë 27.02.2023 përmes vendimit nr 14-118/02-42503/23 ka njoftuar ankuesen se të njëjtes më datë 05.03.2023 i përfundon marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe se bazuar në nenin 22 paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i takon e drejta e kompensimit në shumën prej një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit. Ndërsa më datë 23.03.2023 i njëjti organ i punësimit/Komuna e Prishtinës përmes vendimit me Nr.14-101/03-62754/23 ka njoftuar ankuesen se sipas dispozitave të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtar Publik dhe Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, ankueses i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 05.03.2023 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe përmes këtij vendimi është shfuqizuar Vendimi me nr.14-118/02-42503/23 i datës 27.02.2023.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë kundër Vendimit 14-101/03-62754/23 të datës 23.03.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me pretendimin ankimor se vendimet e organit të punësimit, Komuna e Prishtinës janë kundërthënëse njëra me tjetrin dhe se një veprim i tillë përben padrejtësi për ankuesen duke bërë shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale dhe kërkon që Këshilli t'i njeh të drejtën e kompensimit të një page shtesë me vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, dhe si rrjedhojë bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit/Komuna e Prishtinës ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me këtë çështje administrative, dhe ka aplikuar drejtë dispozitat materiale.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë me nenin 45 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2 është përcaktuar se: "1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që



rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji", e që nënkupton se është shfuqizuar edhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë përkatësisht neni 19 paragrafi 2 i kësaj rregullore që kishte paraparë një të drejtë të tillë për shërbyesit civil, Andaj, me krijimin e këtyre rrethanave te reja ligjore, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka vepruar drejtë me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimit 14-101/03-62754/23 të datës 23.03.2023, sepse Ligji Nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të nëpunësve civile, kështu që pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të bazuara në legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje.

Bazuar në at që u tha si më lartë, Kolegji i këshillit në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.772/2023, datë 09/06/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.